

KONTRATË

Për vijimin e kursit në "Deutschzentrum Kosovo" L.L.C

Kjo kontratë është e lidhur në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 16 me datë 19.06.2012.

Kjo kontratë, lidhet në mes të:

"Deutschzentrum Kosovo" L.L.C, me seli në Rruga "Musine Kokalari, Nr. 12A, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër unik identifikues 810084517, të cilën e përfaqëson Ilir Lenjani me numër personal _____, Drejtor.

Dhe

_____ / _____ nga _____ me adresë _____,
me numër personal _____. (në tekstin e mëtejme, kursanti)

Neni 1 Objekti i Kontratës

1.1 Objekt i kësaj kontrate është ofrimi i kursit të gjuhës gjermane nga "Deutschzentrum Kosovo" L.L.C , për personat e rritur. Të miturit e rritur mbi 16 vjeç, mund të jenë pjesëmarrës dhe palë nënshkruese e kësaj kontrate vetëm pas aprovimit të kërkesës nga "Deutschzentrum Kosovo" L.L.C dhe me lejen - pëlqimin e prindërve apo kujdestarit.

Neni 2 Tarifat

2.1 Tarifat e aplikueshme për vijimin e kursit do të jenë ato tarifa të cilat janë të vlefshme në momentin e regjistrimit të kursit. Këto tarifa janë të paraqitura ne instruksionin e pagesës aktual të "Deutschzentrum Kosovo" dhe janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

2.2 Kurset në "Deutschzentrum Kosovo", ofrohen vetëm si kurse të plota të paraqitura në ofertë sipas fletëpalosjes (fletushkës) dhe faturimi bëhet sipas tarifave të plota të përcaktuara sipas nivelit të kursit. Nëse pagesa e plotë e tarifave të kursit nuk bëhet brenda afatit 3 ditor nga dita e fillimit të kursit, atëherë "Deutschzentrum Kosovo" ka të drejtë ta faturoj shumën për pagesë dhe të njëjtën ta përcjell tek kursanti në e-mail adrese apo në adresën postare dhe për të njëjtën faturë të filloj procedurat përmbarimore në pajtim me Ligjin e Procedurës Përmbarimore.

Prej ditës kur lind detyrimi për pagese do të aplikohet kamata ligjore në lartësinë prej 8% konfrom dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

2.3 Forma e faturimit të lartcekur nuk do të aplikohet ndaj kursantit i cili duke u bazuar në testin vlerësues i propozohet bashkimi në një kurs i cili tani më është duke u mbajtur.

2.4 Familjarët e shkallës së parë (bashkëshorti, fëmija, prindi, dhe motra e vëllau (deri sa nuk janë të martuar) u ofrohet zbritja familjare prej 5% secilit. Pas vijimit dhe përfundimit të nivelit të parë të kursit, "Deutschzentrum Kosovo" i ofron zbritje prej 5% kursantit në tarifën e kursit të nivelit në vazhdim në rast se i njëjti e vazhdon nivelin tjetër brenda 3 muajve. Në rast se "Deutschzentrum Kosovo" nuk arrin brenda 3 muajve ta ofroj kursin e nivelit të radhës, atëherë ky afat zgjatet në 6 muaj.

2.5 Kontraktuesi - kursanti në rast se dëshiron t'i nënshtrohet provimit të ÖSD të organizuar në qendrën tonë përfiton zbritje prej 25%. Kjo zbritje aplikohet në rast se kursanti i nënshtrohet provimit të ÖSD brenda periudhës 3 mujore pas përfundimit të kursit. Zbritja prej 25% nuk aplikohet në rast të përsëritjes së provimit.

Neni 3 Mënyrat e pagesës

3.1 Pas nënshkrimit të kontratës dhe regjistrimit, kursanti njoftohet me afatin e pagesës së detyrimit, i cili është më së largu 3 ditë nga dita e fillimit të kursit. Në rast të dështimit të pagesës brenda afatit të përcaktuar, kursanti e humb të drejtën e vijimit të kursit, përveç nëse "Deutschzentrum Kosovo" i zgjat afatin e përcaktuar të pagesës në rastet e veçanta.

3.2 Pagesat kryhen me anë të transfertës bankare në llogarinë e "Deutschzentrum Kosovo" apo edhe në të gjitha pikat e RIA CAPITAL në Kosovë. Instruksionin e pagesës (faturën) e pranoni përmes e-mailit apo mund ta tërhiqni edhe në zyrën tonë.

Neni 4 Afati i Kontratës

4.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi me datë _____ (**ditën e nënshkrimit**) dhe mbetet e vlefshme deri në përfundimin e obligimeve të ndërsjella.

Neni 5 Obligimet dhe të drejtat e "Deutschzentrum Kosovo"

5.1

- Pas regjistrimit, kursanti njoftohet për vendin e rezervuar në kursin dhe grupin përkatës;
- Deutschzentrum Kosovo, siguron dhe ofron numrin e plotë të orëve të mësimit, sipas nivelit të kursit. Në rast të anulimit të orëve, ato do të zëvendësohen jashtë orarit të rregullt të kursit, ditëve të pushimit apo të shtunave. Zëvendësimi i orëve do të bëhet në koordinim dhe me pajtimin e plotë të shumicës së kursantëve;

- Deutschzentrum Kosovo, i siguron kursantit materialin mësimor duke përfshirë, Librat e kursit, fletore laps kimik;
- Përcakton nivelin e kursantit mbi bazën e testimit të njohurive të mbajtur në Deutschzentrum Kosovo. Përrjashtim nga kjo rregull, bëhet për ish-kursantët apo personat që paraqesin certifikatë të ÖSD, ose të ndonjë qendër testuese të njohur ndërkombëtarisht apo edhe të ndonjë shkolle për mësimin e gjuhës gjermane, e cila është e akredituar nga AKK. Përcaktimi i nivelit bëhet duke u bazuar në certifikatën e provimit, me kusht që data e lëshimit të tyre nuk e kalon periudhën prej 6 muaj.
- Kurset zhvillohen në grupe prej minimalisht 8 dhe maksimalisht 15 pjesëmarrës - kursant. Në rast se në fillim të kursit numri i kursantëve nuk e ka kalon pragun minimal të grupit, atëherë kursantëve u ipet mundësia e kalimit në një kurs tjetër, apo kthimin e plotë të shumës së paguar.
- Deutschzentrum Kosovo gëzon të drejtën, të caktoj dhe sipas nevojës të ndërroj mësimdhënësin dhe gjithashtu të i bashkoj kurset në nivel të njëjtë.
- Deutschzentrum Kosovo, obligohet që ti lëshoj kursantit dëshminë e pjesëmarrjes apo Certifikatën e Arritjes në rast se i njëjti vijon orët e mësimit dhe nëse i kryen të gjitha obligimet ndaj Deutschzentrum Kosovo. Në dëshminë e pjesëmarrjes apo në Certifikatën e Arritjes do të evidentohet numri i orëve mësimore të vijuara nga kursanti si dhe përqindja e rezultateve të testit përfundimtar. Mësimi përlllogaritet mbi bazën e orëve mësimore prej 45 minutash.

Neni 6 Obligimet dhe të drejtat e kontraktuesit - kursantit

6.1

- Kursanti detyrohet që të jetë i rregullt në vijimin e kursit në orarin e përcaktuar nga Deutschzentrum Kosovo;
- Kursanti është i obliguar tu përmbahet afateve të përcaktuara me këtë kontratë për shlyerjen e detyrimeve ndaj Deutschzentrum Kosovo;
- Kursanti obligohet t'i zbatoi të gjitha rregulloret e brendshme të Deutschzentrum Kosovo, dhe i njëjti ka për obligim të shfaq mirësjellje në raport me kursantet tjerë, vizitorët dhe stafin e Deutschzentrum Kosovo;
- Kursanti duhet të shmang çdo sjellje të pa hijshme dhe të pa përshtatshme e cila mund të rezultojë me dëmtimin e pasurisë dhe të mirave të Deutschezentrum Kosovo. Në rast të shkakut të dëmit nga ana e kursantit, atëherë Deutschzentrum Kosovo gëzon të drejtën e kërkesës për kompensimin e të gjitha formave të dëmit.

- Kursanti gëzon të drejtën në shërbimet e përcaktuara me kontratë dhe të ofruara nga Deutschzentrum Kosovo si dhe gëzon trajtim të barabartë me të gjithë kursantet tjerë pa asnjë diskriminim.
- Kursanti fiton të drejtën për vijimin e kursit të nivelit të radhës në rast të arritjes së kriterit të përcaktuar nga të gjitha vlerësimet, gjatë testeve të rregullta gjatë kursit të nivelit aktual. Mesatarja e cila duhet të arrihet për kalueshmëri është suksesi 60%.

Neni 7 Mënyra e komunikimit

7.1 Palët pajtohen që komunikimi në mes të palëve të bëhet në formën e shkruar, në adresat zyrtare elektronike të personave përgjegjës për këtë kontratë, të përshkruara si më poshtë.

Për Deutschzentrum Kosovo - posta elektronike për komunikim do të jetë: info@deutschzentrumkosovo.com, kurse për kontraktuesin kursantit do të jetë _____@_____. Komunikimi i vetëm i pranuar do të jetë posta elektronike ose kërkesat në formë fizike, të dorëzuara në administratën e Deutschzentrum Kosovo.

Neni 8 Ndërprerja e kontratës

8.1 Në rast se kontraktuesi - kursanti, dështon në vijimin e kursit pas konfirmimit për pjesëmarrje apo dëshiron ta shkëpus kontratën, vlejné kushtet e përcaktuara si vijon:

- Në rast se i njëjti paralajmëron mos vijimin, më së largu deri në ditën e tretë pas fillimit të kursit, kur kursi zgjat mbi 7 javë dhe deri në ditën e parë të kursit të të gjitha kurseve më të shkurta, Deutschzentrum Kosovo gëzon të drejtën të mbajë një tarifë administrative prej 20% të vlerës totale të kursit si dhe 20€ për librat e plotësuara, kurse pjesa tjetër e paguar, i kthehet kursantit.
- Në rast të mos vijimit të mëvonshëm të kursit në kundërshtim me afatet e përcaktuara me sipër, kthimi i pagesës apo transferimi nuk është më i mundur, pavarësisht se a e ka ndjekur kursanti kursin apo jo, pasi që tashmë është zënë një vend në grup.

8.2 Ndërprerja e kontratës bëhet duke e paraqitur njoftimin me shkrim në e-mail kontaktues të Deutschzentrum Kosovo apo në kopje fizike në administratë.

8.3 Në rast se Deutschzentrum Kosovo e anulon mbajtjen e një kursi, kursantit i cili e ka kryer pagesën u kthehet tarifa e plotë e paguar. Kursanti në këtë rast, nuk do të ketë kërkesa tjera ndaj Deutschzentrum Kosovo.

Neni 9

Ligji i aplikueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

9.1 Kjo kontratë do të interpretohet në përputhje me Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, përfshirë, mirëpo duke mos u limituar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

9.2 Në bazë të nenit 88 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, palët pajtohen që në rast të paraqitjes së mospajtimeve në lidhje me dispozitat e kësaj kontrate, të angazhojnë bashkërisht një person të tretë i cili do ta bëjë interpretimin e kontratës.

9.3 Mosmarrëveshjet eventuale në lidhje me kontratën do të jetë objekt shqyrtimi nga të dy palët, nëse nuk mund të gjendet ndonjë zgjidhje e pranueshme paraprake për palët, pas shterjes së të gjitha përpjekjeve, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Departamenti përkatës pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

10.1 Kjo Kontratë i shfuqizon të gjitha Kontratat apo marrëdhëniet kontraktuese ndërmjet palëve për objektin e kësaj Kontrate.

10.2 Kjo Kontratë nuk mund të ndryshohet pa pajtimin me shkrim të dy palëve.

10.3 Kjo kontratë është përpiluar në dy kopje identike për palët kontraktuese dhe është shprehje e vullnetit të palëve kontraktuese, të cilët me nënshkrimin personal shprehin pajtueshmërinë e kushteve të përcaktuara në kontratë.

Neni 11

Konfidencialiteti

11.1 Me rastin e regjistrimit të kursit dhe lidhjes së kontratës, kursanti pajtohet që të dhënat e tij të regjistrohen në mënyrë elektronike për përdorim të brendshëm për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit, faturimit dhe të dëshmisë së vijimit të kursit.

11.2 Po ashtu palët kontraktuese zotohen se do ti trajtojnë me konfidencialitet të gjitha informatat e ndërsjella të mësuara të cilat cilësohen si konfidenciale.

E lidhur në _____, më ____/____/_____

Deutschzentrum Kosovo L.L.C

Kursanti : Emri / Mbiemri

v.v